

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Për: **MINISTRIA E INFRASTRUKTURES**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **2024/205-24-13094-5-1-1/B05-0032569**

Sa i përket tenderit për **Zgjerimin e rrugës Nacionale N25, segmenti QMI-Lipjan L=3820.0m**

### 1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

**GOE 4A-M & PREMIUM BETON SH.P.K**

*(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)*

Rr.Nena Tereza p.n.

*(Adresa)*

Prishtinë

*(Vendi)*

10000

*(Kodi postar)*

+38349999299

*(Numri Telefonit)*

*(Numri i Faks-it)*

Granit Sinani

*(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)*

4amdegakosove@gmail.com

*(Adresa elektronike)*

13.06.2025

*(Data e parashtrimit të kërkesës)*



*(Nënshkrimi dhe vula)*

*\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

### 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë me datën 12.12.2024  
B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara i datës 31.12.2024, korrigjimi i dosjes së tenderit  
B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara i datës 04.04.2025, korrigjimi i dosjes së tenderit  
Hapja e ofetrave me datën 14.04.2025  
Vendimi i AK me datën 27.05.2025  
Kërkesa për Rishqyrtim 30.05.2025  
Vendimi për refuzim i Kërkesës për Rishqyrtim 04.06.2025

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

Nuk kam vërejtje.

### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

## 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

*A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

Po ☒

Jo ☐

*Ne përputhje me nenin 108/a të LPP kemi parashtruar Kërkesë për rishqyrtim brenda afateve kohore, respektivisht me date 30.05.2025. Me date 04.06.2025 AK ka nxjerr Vendimin për refuzim të Kërkesës për Rishqyrtim.*

## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

1. Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
2. Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve
3. Neni 54 Njoftimi i Kandidatëve dhe Tenderuesve të Eliminuar
4. Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave
5. Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit
6. Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Më datën 27.05.2025 në përmes sistemit të eprokuimit dhe emailit zyrtarë kemi pranuar vendimin e AK për eliminim të ofertes sone, për Aktivitetin e Prokurimit: **2024/205-24-13094-5-1-1**, sa i përket tenderit për **Zgjerimin e rrugës Nacionale N25, segmenti QMI-Lipjan L=3820.0m**

**ARSYETIMI I AK në NJOFTIMIN MBI VENDIMIN E AK, publikuar me 27.05.2025**

### **Pika 1**

Tenderi juaj eshte refuzuar per mos permbushje te kerkeses se mundesine teknike dhe profesionalei 9.1.dhe 9.2 pika 1.

**Kerkesa 1.**Menaxher i projektit Inxhinier i diplomuar konstruktiv ose infrastrukturë rrugore) 3 vite përvojë pune pas diplomimit . Të ketë dëshmi se ka menaxhuar projekte nga lëmia e kërkuar (sanim të rrëshqitjeve të dheut ,rikonstruktim , ndërtimit, rehabilitimit, apo rikonstruktimit të rrugëve dhe Urave ).

**Dëshmia 1** Leternjoftimi ID, CV e nenshkruar nga vete inxhinieri, diploma, kontrata e punës me ofertuesin, referencat për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit.

Ju keni prezantuar inxhinierin z. D.M mirepo nuk keni ofruar referenca ne lamin e kerkuar sipas kerkeses se lartpermendur.

### **Pika 2**

Tenderi juaj eshte refuzuar per mos permbushje te kerkeses se mundesine teknike dhe profesionalei 9.1.dhe 9.2 pika 6

**Kerkesa 6.**Inxhinier i diplomuar i elektroteknikës me tri vite përvojë pune pas diplomimit ose Bachelor i diplomuar i elektroteknikës me pesë vite përvojë pune pas diplomimit.

**Dëshmia 6** Leternjoftimi ID, CV e nenshkruar nga vete inxhinieri, diploma, kontrata e punës me ofertuesin, referencat për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit.

Ju keni prezantuar inxhinierin z. F.SH ku ka nje mosperputhje dhe nuk eshte ne harmoni me kerkesen e AK dhe keni prezantuar diplomën e inxhinierit Elektro Energjetik i cili nuk eshte ne perputhje me kerkesen e FTD.

### **Pika 3**

Tenderi juaj eshte refuzuar per mos permbushje te kerkeses se mundesine teknike dhe profesionalei 9.1.dhe 9.2 pika 8

**Kerkesa 8.** Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit sipas specifikimit teknik ne dosje te tenderit tek Aneksi 1.

**Deshmia 8.** Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit (pajisjet duhet te jene me afat te regjistrimit), ndërsa pajisje tjera, OE duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë, DUD).

Ju si operatore nuk e keni permbushur kerkesen e lartpermendur.

Ne lidhje me keto pretendime ne kemi parashtuar Kerkese per Rishqyrtim dhe ne kerkesen per rishqyrtim AK ka refuzuar kerkesen tone.

## Pretendimet ankimore ne Kerkesen per rishqyrtim

### Shkelje e nenit 59 , 7 dhe 54 te LPP

Ne, Operator Ekonomik, ju drejtohem me këtë **ankesë zyrtare**, në lidhje me njoftimin për refuzimin e ofertës sonë me pretendimin se nuk kemi përmbushur kërkesat për kapacitet teknik dhe profesional, konkretisht:

- **Kërkesa 1 – Menaxheri i projektit**
- **Kërkesa 6 – Inxhinier i Elektroteknikës**
- **Kërkesa 8 – Lista e pajisjeve teknike**

### Pretendimi yne 1 ne Kerkesen per rishqyrtim:

Konsiderojme se AK ka bere shkeje te nenit 59 te LPP pasi qe nuk ka vleresuar ofertat ne perputhje me kete dispozite.

**Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve, paragrafi 4 percakton** “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmeja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse:

- përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose
- përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve”.

Ju si AK nuk keni vleresuar oferten tone ne perputhje me nenin 59 te LPP pasi qe keni refuzuar oferten e cila oferte ploteson te gjitha kriteret e percaktuara ne Dosje te tenderit.

**Konkretisht per sa i perkete pikes 1 nuk pajtohem me konstatimin tuaj, ku sipas njoftimit tuaj thuhet se:**

**Ju keni prezantuar inxhinierin z. D.M mirepo nuk keni ofruar referenca ne lamin e kerkuar sipas kerkeses se lartpermendur.**

Kerkesa 1.Menaxher i projektit Inxhinier i diplomuar konstruktiv ose infrastrukturë rrugore) 3 vite përvojë pune pas diplomimit . Të ketë dëshmi se ka menaxhuar projekte nga lëmia e kërkuar (sanim të rrëshqitjeve të dheut ,rikonstruktim , ndërtimit, rehabilitimit, apo rikonstruktimit të rrugëve dhe Urave ).

Dëshmia 1 Leternjoftimi ID, CV e nenshkruar nga vete inxhinieri, diploma, kontrata e punës me ofertuesin, referencat për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit.

Në lidhje me këtë, theksojmë se kemi përmbushur tërësisht kërkesën e lartpërmendur. Në ofertën tonë kemi prezantuar inxhinierin z. D.M., i cili:

- Ka diplomë për inxhinieri konstruktive;
- Ka përvojë mbi 3 vite pas diplomimit;
- Ka dorëzuar CV të nënshkruar, letërnjoftim, kontratë pune, si dhe **referenca të mëparshme për projekte të ngjashme**, që përfshijnë: sanim rrëshqitjesh,

ndërtim, rikonstruktiv dhe rehabilitim të rrugëve dhe urave.

Nëse konsideroni se ndonjë element nuk është dorëzuar në mënyrë të plotë ose nuk është në përputhje, ju lutemi të specifikoni saktësisht **cilat dokumente mungojnë apo cilat nuk janë pranuar si të vlefshme**. Njoftimi për refuzimin e ofertës është i paarsyetuar në mënyrë të mjaftueshme, dhe nuk plotëson detyrimin ligjor për të bërë arsyetim të plotë dhe të kuptueshëm. Një vendim i tillë nuk i mundëson ofertuesit të kuptojë saktë pse është refuzuar dhe bie ndesh me nenin 7 “Parimi i Transparencës” dhe nenin 54 “Njoftimi i Kandidatëve dhe Tenderuesve të Eliminuar” të LPP-së “Detyrimi për të arsyetuar vendimin mbi përzgjedhjen ose refuzimin” dhe rrjedhimisht shkelje e nenit 59 të LPP.

**AK, ne pergjigje te Kerkeses per rishqyrtim ka shtuar:**

*Ju si GOE keni prezantuar inxhinierin z. D.M. mirepo nuk keni ofruar referenca ne lemin e kerkuar sipas kerkeses mbi mundesite teknike dhe ose profesionale 9.1 dhe 9.2 pika 1 Menaxher i projektit Inxhinier i diplomuar konstruktiv ose infrastrukturë rrugore) 3 vite përvojë pune pas diplomimit . Të ketë dëshmi se ka menaxhuar projekte nga lëmia e kërkuar (sanim të rrëshqitjeve të dheut ,rikonstruktiv , ndërtimit, rehabilitimit, apo rikonstruktimit të rrugëve dhe Urave ). Ne referencat e prezantuara nga ju ne asnjeren referemce por as ne CV nuk deshmohet se e njejta ka menaxhuar projekte ne lemin e kerkuar (referencat e prezantuara jane ne udheheqese ne vendpunishte refereoju Dosjes suaj ne baze te seciles eshte bere edhe vleresimi i ofertave).*

**Argumenti jone shtese pas refuzimit te kerkeses per rishqyrtim, per pretendimin 1:**

Ne si **GOE**, lidhur me konstatimin e AK se **menaxheri i projektit i propozuar z. D.M. nuk ka dëshmuar përvojë menaxhimi në projektet e kërkuara**, parashtojme këtë ankesë me sqarimet përkatëse:

1. Në dokumentacionin tonë, z. D.M. është prezantuar si **Menaxher i Projektit**, duke përmbyllur kërkesat në pikën 9.1 dhe 9.2 të Dosjes së Tenderit për diplomimin dhe përvojën mbi 3 vjet në fushën përkatëse (ndërtim rrugësh, urash, sanim rrëshqitjesh të dheut, etj.).
2. AK ka vlerësuar se **referencat dhe CV-ja e z. D.M. e prezantojnë atë si “udhëheqës në vendpunishte” dhe jo “menaxher projekti”**, mirëpo dëshirojmë të theksojmë se në praktikën e punëve të ndërtimit, pozita **“udhëheqës i punishtes” është funksionalisht e njëjtë me atë të menaxherit të projektit**.
3. Si **udhëheqës i punishtes**, z. D.M. ka pasur përgjegjësi direkte për planifikimin ditor, koordinimin teknik dhe organizimin e të gjitha veprimtarive ndërtimore në terren, bashkëpunimin me mbikëqyrësin, zgjidhjen e problemeve teknike dhe ndjekjen e afateve kohore të projektit, çka përbën thelbin e rolit të kërkuar si “menaxher projekti”.
4. Në këtë drejtim, referencat e ofruara janë **plotësisht të vlefshme dhe përmbyllin informacione të qarta për llojin e projekteve të realizuara** (rrugë, ura, sanime të rrëshqitjeve), si dhe për rolin vendimtar të z. D.M. në implementimin e tyre.
5. Prandaj, **përdorimi i termit ndryshe (“udhëheqës i punishtes” në vend të “menaxher projekti”)** nuk duhet të interpretohet si mospërmbyllje e kërkesës, për sa kohë funksioni real dhe përgjegjësitë janë të njëjta

## Pretendimi yne 2 ne Kerkesen per rishqyrtim:

**Nuk pajtohem me konstatimin tuaj ne lidhje me piken 2, ku sipas njoftimit tuaj thuhet se:**

***Ju keni prezantuar inxhinierin z. F.SH ku ka nje mosperputhje dhe nuk eshte ne harmoni me kerkesen e AK dhe keni prezantuar diplomen e inxhinierit Elektro Energjetik i cili nuk eshte ne perputhje me kerkesen e FTD.***

Kerkesa 6. Inxhinier i diplomuar i elektroteknikës me tri vite përvojë pune pas diplomimit ose Bachelor i diplomuar i elektroteknikës me pesë vite përvojë pune pas diplomimit.

Dëshmia 6 Leternjoftimi ID, CV e nënshkruar nga vete inxhinieri, diploma, kontrata e punës me ofertuesin, referencat për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit.

**Nuk pajtohem me konstatimin tuaj ku thuhet se:**

***"Ju keni prezantuar inxhinierin z. F.SH ku ka një mospërputhje dhe nuk është në harmoni me kërkesën e AK dhe keni prezantuar diplomën e inxhinierit Elektro Energjetik i cili nuk është në përputhje me kërkesën e FTD."***

Ky konstatim është i pabazuar dhe në kundërshtim me parimet e barazisë dhe trajtimit të drejtë të operatorëve ekonomikë, sepse:

- Në dosjen e tenderit (FTD), kërkesa është për:

**"Inxhinier i diplomuar i elektroteknikës"**, pa specifikuar drejtimin apo ndonjë nën-profesion brenda elektroteknikës.

- **Elektroteknika është një fushë e gjerë**, e cila përfshin disa drejtime si:
  - Elektroenergjetikë,
  - Elektronikë,
  - Telekomunikacion,
  - Automatizim industrial, etj.
- Diploma e paraqitur nga ana jonë – në **Elektroenergjetikë** – është **nën-fushë e elektroteknikës** dhe si e tillë është **plotësisht në përputhje me kërkesën tuaj të përgjithshme**.
- Ju **nuk keni kërkuar ndonjë profil të veçantë apo specifikim shtesë**, prandaj përjashtimi i diplomës sonë për arsye të "drejtimit" është i paarsyeshëm dhe në kundërshtim me nenin **7 dhe 59 të Ligjit për Prokurimin Publik**, si dhe me parimin e proporcionalitetit dhe transparencës.

Per me teper:

- **Diploma e prezantuar është e lëshuar nga një institucion i akredituar** dhe titulli "Inxhinier i Elektro-Energjetikës" është **nën-drejtim i fushës së Elektroteknikës**, ashtu siç pranohet edhe nga Këshilli Shtetëror i Cilësisë dhe Korniza Kombëtare e Kualifikimeve.
- Ky profil arsimor është **brenda fushës së kërkuar – Elektroteknikës**, dhe si i tillë **përbush plotësisht kërkesën e Dosjes së Tenderit**.
- Po ashtu, kemi ofruar **CV të nënshkruar, letërnjoftim, kontratë pune me ofertuesin dhe referenca për punë në lëmin e kërkuar**, të gjitha në përputhje me Dëshminë 6.

**Diploma në Inxhinieri Elektroenergjetike duhet të konsiderohet e vlefshme dhe përputhëse me kërkesën për “Inxhinier të Elektroteknikës”, pasi elektroenergjetika është një nën-drejtim i fushës së gjerë të elektroteknikës.** Kjo mbështetet në faktin se në sistemin arsimor universitar, **Inxhinieria e Elektroenergjetikës është e strukturuar brenda Fakultetit të Inxhinierisë Elektroteknike**, dhe përmbajtja kurrikulare mbulon kompetenca thelbësore të elektroteknikës në nivel të avancuar.

Më tej, **në mungesë të një specifikimi më të ngushtë nga autoriteti kontraktues**, si p.sh. “drejtimi elektronikë”, **çdo drejtim brenda elektroteknikës duhet të konsiderohet i pranueshëm** në kuptim të përmbushjes së kërkesës së përgjithshme për “Inxhinier Elektroteknik”.

Refuzimi i diplomës në Inxhinieri Elektroenergjetike vetëm mbi bazën e titullit, pa analizuar përmbajtjen dhe lidhshmërinë funksionale të kualifikimit me kërkesën, **përbëntshkelje të parimit të trajtimit të barabartë dhe proporcionalitetit** të përcaktuar në nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) dhe shkeje te nenit 59 te LPP.

Kërkojmë që të rishqyrtohet ky konstatim, pasi refuzimi i diplomës së “Inxhinierit të Elektroenergjetikës” si jo relevante për fushën e Elektroteknikës është **i paarsyeshëm dhe i pabazuar në standardet akademike dhe profesionale të njohura në vend.** **Kërkojmë që ky konstatim të rishqyrtohet dhe të konsiderohet diploma si e vlefshme**, pasi përndryshe do të përbënte një kufizim të padrejtë dhe të paarsyetuar të konkurrencës dhe një zbatim të gabuar të kriterëve.

#### **AK, ne pergjigje te Kerkeses per rishqyrtim ka shtuar:**

*AK ka vlersuar konform dosje se tenderi neni 9.1.dhe 9.2 konkretisht pika 6 ku eshet kerkuar 6.Inxhinier i diplomuar i elektroteknikës me tri vite përvojë pune pas diplomimit ose **Bachelor i diplomuar i elektroteknikës** me pesë vite përvojë pune pas diplomimit. Dëshmia ka qene Dëshmia 6 Letërnjoftimi ID, CV e nënshkruar nga vete inxhinieri, diploma, kontrata e punës me ofertuesin, referencat për punët e mëparshme në lëmin e kerkuar të lëshuara nga punëdhënësit.*

*Ndersa ju ne oferten tuaj keni prezantuar per te permbushur kerkesen per piken 6 inxhinierin z. F.SH ku ka një mospërputhje dhe nuk është në harmoni me kërkesën e AK - se me deshmite e prezantuar nga ju si OE , ju keni prezantuar diplome te master Elekrtik Elektroenergjetike dhe diploma batchelor Elektrik/Formues Energjetik, perveq kesaj ne CV e dorezuar dhe nenshkuar nga vete inxhinieri figuron se nuk eshte Inxhinier i Elektroteknikes dhe i njejti nuk eshte ne perputhje me kerkesen e DT.*

#### **Argumenti jone shtese pas refuzimit te kerkeses per rishqyrtim, per pretendimin 2:**

Ne si **GOE** në lidhje me njoftimin e AK mbi vlerësimin e dokumentacionit tonë për pozitën e kerkuar në **piken 6 të nenit 9.1 dhe 9.2 të Dosjes së Tenderit** (Inxhinier i Elektroteknikës), dëshirojmë të parashtrojmë këtë **ankesë** me sqarimet përkatëse:

1. Ne kemi prezantuar për këtë pozitë z. **F.SH.**, për të cilin janë bashkëngjitur dokumentet:
  - Diplomë **Bachelor** në drejtimin “**Elektrik / Formues Energjetik**”,
  - Diplomë **Master** në drejtimin “**Elektroenergjetik**”,
  - **CV e nënshkruar**,
  - **Kontrata e punës**,
  - **Letërnjoftimi**,
  - **Referencat për punë të mëparshme në fushën përkatëse.**
2. Këto dëshmi, të cilat përfshijnë **arsimin dhe përvojën profesionale në fushën e elektroteknikës**, janë **në përputhje me kërkesën e Autoritetit Kontraktues** që



përcakton:

"Inxhinier i diplomuar i elektroteknikës me tri vite përvojë pune pas diplomimit ose Bachelor i diplomuar i elektroteknikës me pesë vite përvojë pune pas diplomimit."

3. Diploma e **Masterit në Elektroenergjetikë** përfaqëson një **specializim brenda fushës së Elektroteknikës** dhe është e njohur ligjërisht si **niveli më i lartë i kualifikimit në të njëjtin drejtim**, çka përmbush plotësisht kushtin për "Inxhinier të diplomuar të Elektroteknikës".
4. Përveç kësaj, **edhe diploma Bachelor**, megjithëse përmend termin "Formues Energjetik", është e lëshuar nga një **Fakultet Teknik me drejtim Elektroteknik**, gjë që vërtetohet përmes përmbajtjes së kurrikulës dhe sistemit arsimor në fuqi në Republikën e Kosovës.
5. Sqarimi se në **CV-në e nënshkruar nga z. F.SH.** nuk përmendet titulli "Inxhinier i Elektroteknikës" nuk përbën bazë ligjore për skualifikim, pasi **titulli dhe kualifikimi profesional burojnë nga diplomat zyrtare**, jo nga mënyra e vetëpërshkrimit në CV. Kjo mospërputhje nuk ndryshon faktin thelbësor se kandidati ka të përfunduar studimet përkatëse dhe ka përvojën në fushën e kërkuar.
6. Nëse Autoriteti Kontraktues kishte paqartësi mbi përputhshmërinë e diplomës me kërkesat e Dosjes së Tenderit, është dashur të **aktivizojë procedurën për sqarim të ofertës**, përpara marrjes së vendimit për skualifikim

### **Pretendimi yne 3 ne Kerkesen per rishqyrtim:**

**Nuk pajtohem me konstatimin tuaj ne lidhje me piken 3, ku sipas njoftimit tuaj thuhet se:**

***Ju si operatore nuk e keni permbushur kerkesen e lartpermendur.***

"Kerkesa 8. Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit sipas specifikimit teknik ne dosje te tenderit tek Aneksi 1.

Deshmia 8. Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit (pajisjet duhet të jene me afat te regjistrimit), ndërsa pajisje tjera, OE duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë, DUD)."

Në lidhje me këtë, theksojmë se kemi përmbushur tërësisht kërkesën e lartpërmendur. Në ofertën tonë kemi dorëzuar:

- Listën e plotë të pajisjeve dhe makinerive teknike të kërkuara për realizimin e projektit;
- Librezat e regjistrimit për të gjitha pajisjet e regjistrueshme, me afate të vlefshme të regjistrimit;
- Dokumente pronësie për pajisjet tjera.

Në dokumentin bashkëngjitur në ofertë (bashkëngjitur sërish me këtë ankesë), dëshmohet përmbushja e plotë e kërkesës. **Njoftimi i refuzimit nuk specifikon se cilat pajisje mungojnë ose cilat dokumente nuk janë pranuar si të vlefshme**, që bie ndesh me nenin 54 të LPP-së, i cili obligon Autoritetin Kontraktues të paraqesë arsye të qarta dhe të argumentuara për refuzimin e ofertës. **Ju lutemi të shihni dokumentin e bashkëngjitur**, ku janë paraqitur të gjitha pajisjet e ofruara me ofertën tonë, së bashku me të dhënat për afatet e regjistrimit dhe dokumentacionin përkatës të pronësisë. Meqë në njoftimin tuaj nuk është specifikuar asnjë pajisje apo dokument konkret që mungon apo nuk është i pranueshëm, kërkojmë që **Të rishqyrtoni vendimin për refuzimin e ofertës sonë.**

**AK, ne pergjigje te Kerkeses per rishqyrtim ka shtuar:**

Tek kerkesa 14/16 Cilinder me rrota hekuri per vibrim min 3 ton nuk keni ofru deshmi se paisja Rul Tandem Roller BW 80AD pesha 4.3 ton eshet sipas kerkeses dhe pajisja 16/18 sperkates per bitumen dhe emulsion nuk eshet sipas kerkeses se FTD pasi qe ne pershkrimin e paisjes nuk figuron qe eshte sipas kerkeses.

**Argumenti jone shtese pas refuzimit te kerkeses per rishqyrtim, per pretendimin 3:**

Në emër të **GoE**, parashtrojmë këtë **ankesë** lidhur me vlerësimin mbi mungesën e përputhshmërisë së pajisjeve të ofruara nga ne për pozitat 14 dhe 16, si vijon:

**1. Pajisja për pikën 16 – Cilindër me rrota hekuri me vibrim, min 3 ton**

Në ofertën tonë kemi ofruar pajisjen:

**Rul Tandem Roller model BW 80 AD, me peshë operative 4.3 ton, që tejkalon minimumin prej 3 ton të kërkuar në Dosjen e Tenderit.**

- Kjo pajisje është **me vibrim**,
- Është **cilindër me rrota hekuri (drum roller)**,

DPD - ASYCUDAWorld

2 Eksportuesi RITCHIE BROS BV MARK S CLARKELAAN 21 4761 RK ZEVENBERGEN NLD		1 DEKLARATE IM 4 3 1 1 4 Lista 1 1 5 Artikuj 1 2 6 Nr. kodive 2023 7 Numri i referencës #887		AL110000 23AL110000/8916H9 Tirana Referenca e R 78916 31/07/2023 Manifesti	
8 Marresi 4 A-M- SHPK Rr. ARTAN LENJA, PALLATI I 4 A-M Nr. AP-1, KATI I TIRANE TIRANE		9 Financiare Nr.		10 Vendi i NL 11 Vendi i NL 12 Detajet e vlerës 423,400 13 P.P.B.	
14 Best Choice Vore, Mucaj Terminali i Doganes Tirane		15 Vendi dergues/eksportues Hollanda 16 Vendi origjines Hollanda		17 V.D. Kodi a NL b   c   d   e   f   g   h   i   j   k   l   m   n   o   p   q   r   s   t   u   v   w   x   y   z   AA   AB   AC   AD   AE   AF   AG   AH   AI   AJ   AK   AL   AM   AN   AO   AP   AQ   AR   AS   AT   AU   AV   AW   AX   AY   AZ   BA   BB   BC   BD   BE   BF   BG   BH   BI   BJ   BK   BL   BM   BN   BO   BP   BQ   BR   BS   BT   BU   BV   BW   BX   BY   BZ   CA   CB   CC   CD   CE   CF   CG   CH   CI   CJ   CK   CL   CM   CN   CO   CP   CQ   CR   CS   CT   CU   CV   CW   CX   CY   CZ   DA   DB   DC   DD   DE   DF   DG   DH   DI   DJ   DK   DL   DM   DN   DO   DP   DQ   DR   DS   DT   DU   DV   DW   DX   DY   DZ   EA   EB   EC   ED   EE   EF   EG   EH   EI   EJ   EK   EL   EM   EN   EO   EP   EQ   ER   ES   ET   EU   EV   EW   EX   EY   EZ   FA   FB   FC   FD   FE   FF   FG   FH   FI   FJ   FK   FL   FM   FN   FO   FP   FQ   FR   FS   FT   FU   FV   FW   FX   FY   FZ   GA   GB   GC   GD   GE   GF   GG   GH   GI   GJ   GK   GL   GM   GN   GO   GP   GQ   GR   GS   GT   GU   GV   GW   GX   GY   GZ   HA   HB   HC   HD   HE   HF   HG   HH   HI   HJ   HK   HL   HM   HN   HO   HP   HQ   HR   HS   HT   HU   HV   HW   HX   HY   HZ   IA   IB   IC   ID   IE   IF   IG   IH   II   IJ   IK   IL   IM   IN   IO   IP   IQ   IR   IS   IT   IU   IV   IW   IX   IY   IZ   JA   JB   JC   JD   JE   JF   JG   JH   JI   JJ   JK   JL   JM   JN   JO   JP   JQ   JR   JS   JT   JU   JV   JW   JX   JY   JZ   KA   KB   KC   KD   KE   KF   KG   KH   KI   KJ   KK   KL   KM   KN   KO   KP   KQ   KR   KS   KT   KU   KV   KW   KX   KY   KZ   LA   LB   LC   LD   LE   LF   LG   LH   LI   LJ   LK   LL   LM   LN   LO   LP   LQ   LR   LS   LT   LU   LV   LW   LX   LY   LZ   MA   MB   MC   MD   ME   MF   MG   MH   MI   MJ   MK   ML   MN   MO   MP   MQ   MR   MS   MT   MU   MV   MW   MX   MY   MZ   NA   NB   NC   ND   NE   NF   NG   NH   NI   NJ   NK   NL   NM   NO   NP   NQ   NR   NS   NT   NU   NV   NW   NX   NY   NZ   OA   OB   OC   OD   OE   OF   OG   OH   OI   OJ   OK   OL   OM   ON   OO   OP   OQ   OR   OS   OT   OU   OV   OW   OX   OY   OZ   PA   PB   PC   PD   PE   PF   PG   PH   PI   PJ   PK   PL   PM   PN   PO   PP   PQ   PR   PS   PT   PU   PV   PW   PX   PY   PZ   QA   QB   QC   QD   QE   QF   QG   QH   QI   QJ   QK   QL   QM   QN   QO   QP   QQ   QR   QS   QT   QU   QV   QW   QX   QY   QZ   RA   RB   RC   RD   RE   RF   RG   RH   RI   RJ   RK   RL   RM   RN   RO   RP   RQ   RR   RS   RT   RU   RV   RW   RX   RY   RZ   SA   SB   SC   SD   SE   SF   SG   SH   SI   SJ   SK   SL   SM   SN   SO   SP   SQ   SR   SS   ST   SU   SV   SW   SX   SY   SZ   TA   TB   TC   TD   TE   TF   TG   TH   TI   TJ   TK   TL   TM   TN   TO   TP   TQ   TR   TS   TT   TU   TV   TW   TX   TY   TZ   UA   UB   UC   UD   UE   UF   UG   UH   UI   UJ   UK   UL   UM   UN   UO   UP   UQ   UR   US   UT   UU   UV   UW   UX   UY   UZ   VA   VB   VC   VD   VE   VF   VG   VH   VI   VJ   VK   VL   VM   VN   VO   VP   VQ   VR   VS   VT   VU   VV   VW   VX   VY   VZ   WA   WB   WC   WD   WE   WF   WG   WH   WI   WJ   WK   WL   WM   WN   WO   WP   WQ   WR   WS   WT   WU   WV   WW   WX   WY   WZ   XA   XB   XC   XD   XE   XF   XG   XH   XI   XJ   XK   XL   XM   XN   XO   XP   XQ   XR   XS   XT   XU   XV   XW   XX   XY   XZ   YA   YB   YC   YD   YE   YF   YG   YH   YI   YJ   YK   YL   YM   YN   YO   YP   YQ   YR   YS   YT   YU   YV   YW   YX   YY   YZ   ZA   ZB   ZC   ZD   ZE   ZF   ZG   ZH   ZI   ZJ   ZK   ZL   ZM   ZN   ZO   ZP   ZQ   ZR   ZS   ZT   ZU   ZV   ZW   ZX   ZY   ZZ	
18 Identiteti dhe kombesia e mjeteve te transportit ne BU033IA/AA643BU 21 Identiteti dhe kombesia e mjeteve te transportit ne kufi GRUPAZH 25 Menyra 31 31 26 Menyra e 31 Transporti 27 Vendi ngarjes/shkarkimit AL07 Morina AL110000		19 Kl. RS 20 Kushtet e levimit EXW NL 22 Mon & shuma totale ne fature EUR 40,400.00 23 Kursi kembimit 105.850 24 Natyra 1 1 transaksio		28 Te dhena financiare & bankare Kushtet e	
31 Kolla dhe pershkrim i mallit Shenja dhe nr I pakove Numri dhe 2 31 Lloji Lidhje --- Vibratore RRULA ASFALTI PER SHTRIMIN E RRUGEVE CP 2 SN: 101880382446, 2018/ SN: 101462091072 2018		32 Artikulli 1 No 33 Kodi tarifler 84294010 000 34 Kodi V.O. a) NL b) 4,300.0000 35 Pesha bruto (kg) 36 Prefer. 37 REGIMI 4000 000 4,300.0000 38 Pesha Neto (kg) 39 Kuota 40 Përmbledhja e deklarates/ Dokumenti i S/L			



•

Dhe plotëson në mënyrë të qartë specifikimin minimal të kërkuar, si për peshën ashtu edhe për funksionin.

Vërejtja se nuk kemi ofruar dëshmi për përputhshmërinë është e pasaktë, sepse në dokumentacion kemi bashkëngjitur përveq dokumenteve të kërkuara si dëshmi EDHE Fotografi të pajisjes.

## 2. Pajisja për pikën 14 – Spërkatës për bitumen dhe emulsion



Në ofertën tonë kemi prezantuar pajisjen **Spërkatës për bitumen dhe emulsion**, për të cilën kemi ofruar Foto dhe të dhëna të tjera që tregojnë se pajisja është e përshtatshme për aplikimin e dy përbërësve të kërkuar në tender.

Vlerësimi juaj që “nuk figuron se është sipas kërkesës” është i pasaktë, pasi kërkesa ishte e përgjithshme (spërkatës për bitumen dhe emulsion), pa specifikime shtesë teknike, dhe përmbajtja e dokumenteve të ofertës sonë qartë demonstroi këtë funksionalitet.

### Shkelje e nenit 54 të LPP

Sipas Nenit 54, paragrafi 1 i Ligjit për Prokurimin Publik, përcaktohet:

*“Kurdo që një autoritet kontraktues e eliminon një kandidat ose tenderues nga pjesëmarrja e mëtejshme në aktivitetin e prokurimit, autoriteti i tillë kontraktues duhet që menjëherë të njoftojë kandidatin ose tenderuesin me shkrim mbi këtë fakt. Njoftimi i tillë duhet që së paku të përmbajë informatat të cilat shpjegojnë arsyet përkatëse në përputhshmëri me: [...]”*

Në veçanti, sipas paragrafit 1.2 të këtij neni:

*“Në rast të eliminimit të një tenderuesi që është eliminuar për shkak të parregullsive ose përndryshe tenderit të papërshtatshëm, njoftimi do të saktësojë mungesat në një tender të tillë.”*

Në njoftimin e pranuar nga Autoriteti Kontraktues (AK), arsyet e eliminimit janë paraqitur në mënyrë të përgjithësuar dhe pa specifikuar qartë mangësitë konkrete që kanë çuar në eliminim. Kjo përbën shkelje të detyrimeve ligjore të përcaktuara në nenin e lartcekur.

Për ilustrim, në njoftimin e AK-së janë dhënë vlerësime të paqarta si më poshtë:

- *“Ju keni prezantuar inxhinierin z. D.M mirëpo nuk keni ofruar referenca në lëmin e kërkuar sipas kërkesës së lartpërmendur.”* - Cila është konkretisht lëmi që nuk është përmbushur?
- *“Ju keni prezantuar inxhinierin z. F.SH ku ka një mospërputhje dhe nuk është në harmoni me kërkesën e AK dhe keni prezantuar diplomën e inxhinierit Elektro-Energjetik, i cili nuk është në përputhje me kërkesën e FTD.”* – Cila është konkretisht mospërputhja?
- *“Në lidhje me pajisjet: Ju si operator nuk e keni përmbushur kërkesën e lartpërmendur.”* – Cila kërkesë specifike për pajisje nuk është përmbushur?

Këto pohime janë të përgjithshme dhe nuk përmbajnë specifikime të qarta për dokumentet që mungojnë, referencat e papranueshme, ose për mospërputhjet konkrete. Kjo e bën të pamundur për një operator ekonomik të kuptojë bazën reale dhe ligjore të eliminimit.

Ky veprim është në kundërshtim me parimin e **transparencës** dhe të **së drejtës për mbrojtje efektive**, pasi një operator ekonomik duhet të ketë mundësinë të kuptojë plotësisht arsyet e refuzimit për të mundësuar ushtrimin e një mjeti juridik të drejtë dhe të informuar.

Prandaj, konsiderojmë se veprimi i Autoritetit Kontraktues ka ra ndesh me dispozitat e **Nenit 54 të LPP-së** pasi që vetëm pas kërkesës për rishqyrtim ka paraqitur disa arsye shtese të cilat ishte dashte që në vendosen në Njoftimin mbi Vendimin e AK në përputhje me nenin 54 i cili nën përcakton: *Në rast të eliminimit të një tenderuesi që është eliminuar për shkak të parregullsive ose përndryshe tenderit të papërshtatshëm, njoftimi do të saktësojë mungesat në një tender të tillë.*

### **Shkelje e nenit 62 të LPP**

Sipas **nenit 62, paragrafi 1 të Ligjit për Prokurimin Publik**, përcaktohet qartë se: *“Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërin nga arsyet: 1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodhë në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.”*

Gjithashtu, **neni 43.5 i Rregullores për Prokurimin Publik** përcakton se procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave mund të anulohet vetëm për një nga arsyet e mëposhtme:

b. *asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm.*

Në rastin konkret, **AK ka anuluar aktivitetin e prokurimit, edhe pse konsiderojmë se oferta jonë është e përgjegjshme.** Ky veprim përbën **shkelje të nenit 62 të LPP-së**

## dhe nenit 43.5 të Rregullores.

Në rastin tonë, **oferta jonë ka qenë e përgjegjshme**, dhe AK nuk ka ofruar **asnjë arsyetim të ligjshëm** përse është konsideruar e papranueshme. Vendimi për anulim, për më tepër pas eliminimit të padrejtë të operatorëve, është **i pajustificuar ligjërisht dhe i cënueshëm proceduralisht**.

Anulimi në këto rrethana:

- është i pabazuar në ligj;
- dëmton konkurrencën dhe parimet e transparencës dhe trajtimit të barabartë;
- përbën vendim administrativ arbitrar që mund të konsiderohet **keqpërdorim i diskrecionit ligjor nga ana e AK-së**.

Për këtë arsye, kërkojmë **anulimin e vendimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe vazhdimin e procedurës në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe Rregullores për Prokurim**.

## Shkelje e nenit 72 dhe nenit 59.2 të LPP

Sipas **nenit 72 të Ligjit për Prokurimin Publik**, përcaktohet:

*“Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumente specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.”*

Po ashtu, **neni 59.2 i të njëjtit ligj** përcakton se:

*“Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohet ose pranohet nga autoriteti kontraktues ose të ofrohet nga një tenderues.”*

Në rastin konkret, **AK ka vendosur të eliminojë ofertën tonë pa shfrytëzuar të drejtën që i jep ligji për të kërkuar sqarime** në lidhje me çështjet që pretendohen si mangësi. Kjo është **shkelje e drejtpërdrejtë e nenit 72 dhe nenit 59.2 të LPP-së**, duke pasur parasysh se:

- Nëse AK ka pasur paqartësi mbi referencat e inxhinierit apo dokumentacionin për pajisjet, **ka pasur mundësinë ligjore dhe detyrimin moral që të kërkojë sqarime para se të eliminojë operatorin**.
- Moskërkimi i sqarimeve dhe eliminimi i menjëhershëm tregon **qëllim të caktuar për të përjashtuar operatorin ekonomik**, duke minuar parimet e transparencës, trajtim të barabartë dhe konkurrencës së ndershme.

Në rastin konkret, përpara eliminimit, **AK ka pasur mundësinë ligjore dhe detyrimin që të kërkojë sqarime**, por nuk e ka bërë këtë. Mungesa e një kërkesë të tillë tregon **qëllim përjashtues dhe selektiv**, që bie ndesh me frymën e ligjit.

## Shkelje e nenit 56 të LPP

Sipas nenit 56 të LPP-së, paragrafi 3:

*“Tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.”*

Në dosjen e tenderit, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar **“Inxhinier të diplomuar të elektroteknikës”**, pa specifikuar drejtimin e saktë ose ndonjë nën-profesion brenda kësaj fushe. Elektroteknika është një **fushë e gjerë**, që përfshin:

- Elektroenergjetikën,
- Elektronikën,
- Telekomunikacionin,
- Automatizimin industrial,
- Sistemet e kontrollit, etj.

**Diploma që kemi dorëzuar – në fushën e Elektroenergjetikës – është nën-fushë e elektroteknikës**, dhe si e tillë përputhet plotësisht me kërkesën e Autoritetit Kontraktues, i cili ka formuluar kriterin në mënyrë të përgjithshme.

Vendimi për të eliminuar ofertën tonë mbi këtë bazë përbën:

- Një **shkelje të Nenit 56.3 të Ligjit për Prokurimin Publik**, i cili ndalon eliminimin e operatorëve ekonomikë për kërkesa që nuk janë të qarta, të përcaktuara dhe të paraqitura në dokumentacionin e tenderit.
- Një **cenim serioz të parimit të trajtimit të barabartë dhe hapjen e rrugës për interpretime subjektive**, gjë që është kundër transparencës dhe konkurrencës së ndershme.

Nëse Autoriteti Kontraktues kishte për qëllim të kërkonte një drejtim specifik brenda elektroteknikës, ai **duhej ta specifikonte qartë këtë në FTD**, ashtu siç kërkon ligji. Mosbërja e kësaj dhe eliminimi i mëvonshëm mbi bazën e interpretimeve të njëanshme përbën **veprim të paautorizuar ligjërisht dhe i kontestueshëm**.

Bazuar në pretendimet tona të elaboruara më lartë kërkojm nga OSHP që pretendimet tona dhe ANKESEN tonë ta trajtoj në hollësi dhe nga kjo të miratoj:

## **Vendim**

Aprovohet e bazuar kërkesa e operatorit ekonomik **GOE 4A-M &PREMIUM BETON SH.P.K** në lidhje me aktivitetin me titull **Zgjerimin e rrugës Nacionale N25,segmenti QMI-Lipjan L=3820.0m, me numer te prokurimit 2024/205-24-13094-5-1-1**

Anulohet njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues te dates 27.05.2025 dhe lënda të kthehet në **rivlerësim dhe pas rivlerësimit** të shpallemi fitues të këtij aktiviteti të prokurimit.

## **9. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Autoriteti Kontraktues nuk ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, duke eliminuar padrejtësisht ofertën tonë, gjë që ka shkaktuar pasoja të drejtpërdrejta materiale, përfshirë:

- Kostot e përgatitjes së ofertës dhe dokumentacionit mbështetës;
- Dëmin ekonomik të shkaktuar nga humbja e një kontrate të mundshme;
- Pengesën në realizimin e investimeve të planifikuara për këtë aktivitet.

**Për këto arsye, duke u mbështetur në Ligjin për Prokurimin Publik dhe rregulloren përkatëse, kërkojmë nga OSHP që:**

1. **Të anulojë Njoftimin mbi Vendimin të datës 27.05.2025;**
  2. **Të kthejë çështjen në procedurë të ri-vlerësimit;**
  3. **Si rrjedhojë, të shpallë ofertën tonë si të përgjegjshme.**
- Kjo kërkesë është në funksion të respektimit të parimeve të transparencës, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë

## **10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

1. *një kopje e Njoftimit mbi kontratë*
2. *një kopje e Njoftimit mbi Vendimin e AK*
3. *nje kopje e Kerkeses per rishqyrtim*
4. *një kopje të vendimit të AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përfundim me nenin 108A të LPP-se,*
5. *Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përfundim me nenin 118 të LPP-se, dhe*

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*